

### RRETHI SHKENCOR I STUDIMEVE TË DEGËS SË GJUHËS SHQIPE NJIHET ME ARRITJET E GJUHËSISË SHQIPTARE PAS ÇLIRIMIT

Në kuadrin e punës së zhvilluar për nder të 30-vjetorit të Çlirimit të Atdheut dhe të fitores së revolucionit popullor, rrethi shkencor i gjuhësisë pranë Fakultetit të Historisë e të Filologjisë, në bashkëpunim me Sektorin e leksikologjisë e të leksikografisë të Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë dhe me Katedrën e gjuhës shqipe, organizoi më 11 dhjetor 1974 një bisedë me prof. Androkli Kostallarin, drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, për sukseset e gjuhësisë shqiptare gjatë këtyre 30 vjetëve.

Në këtë takim, përveç studentëve të degës së gjuhës e të letërsisë shqipe, merrnin pjesë edhe pedagogë të kësaj dege si dhe punonjës shkencorë të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.

Në fillim, studenti Ali Jashari foli për kujdesin e madh që i ka kushtuar Partia dhe Pushteti ynë popullor zhvillimit të vazhdueshëm të shkencave albanologjike si dhe për sukseset e arritura nga gjuhësia shqiptare në këta 30 vjet çlirim, duke u ndalur në mënyrë të veçantë në fushën e studimit të gjuhës letrare shqipe, të fjalëformimit

dhe të leksikologjisë e të leksikografisë.

Pastaj prof. A. Kostallari foli më gjërë për zhvillimin e gjuhësisë shqiptare dhe në përgjithësi të shkencave albanologjike në periudhën pas Çlirimit të vendit. Duke folur për sukseset e arritura gjatë kësaj kohe, ai theksoi në mënyrë të veçantë, se merita kryesore, vendimtare në zhvillimin e shkencës gjuhësore marksiste shqiptare i takon padyshim Partisë sonë, udhëheqjes së drejtë e largpamëse të saj, që problemet e gjuhës shqipe në përgjithësi dhe të gjuhës letrare kombëtare në veçanti, i bëri çështje të të gjithë popullit, çështje thelbësore të punës shkencore në këtë fushë. «Kjo gjuhësi — tha ai, — është pjellë e Partisë, është krijimi i saj dhe të tërë ne jemi krijesa shkencore të Partisë sonë. Edhe ata gjuhëtarë të sotëm që e kanë nisur punën para Çlirimit janë krijesa të Partisë, sepse faktor vendimtar për punën e tyre të vërtetë shkencore dhe për rritjen e tyre ideo-profesionale ka qenë dhe është kujdesi i vazhdueshëm i Partisë dhe i Pushtetit Popullor». Ai theksoi se, ndër-

sa në vendet kapitaliste e revizioniste talentet e vërteta mbyten ose e çajne rrugën me vështirësi të madhe, në vendin tonë si pasojë e kujdesit të vazhdueshëm të Partisë e të Pushtetit Popullor, si në çdo fushë tjetër edhe në gjuhësi lindin e zhvillohen çdo ditë punonjës të rinj nga masat e gjera të popullit. Provë shumë e qartë dhe bindëse e këtij kujdesi dhe e këtij masivizimi që mbajtja me sukses e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe në nëntor 1972 si edhe tërë veprimtaria shkencore që zhvillohet te ne në fushën e albanologjisë.

Pastaj prof. A. Kostallari foli për luftën që u ka bërë dhe u bën gjuhësia jonë koncepteve dhe teorive të gabuara, antimarksiste e armiqësore, sidomos lidhur me gjuhën shqipe, me marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera, me pasurinë reale të gjuhës shqipe dhe me rrugët e zhvillimit të saj. Ai parashtroi arritjet kryesore të gjuhësisë së re shqiptare pas Çlirimit në fushat më të rëndësishme, duke bërë një sintezë të zhvillimit të mendimit gjuhësor marksist shqiptar pas Çlirimit. Kjo veprimtari ka bërë që gjuhësia shqiptare të thotë sot fjalën më të autoritetshme shkencore për problemet e gjuhës shqipe e të historisë së saj dhe të zërë një vend të dorës së parë edhe në lëmin e ballkanistikës. Ndërsa në të kaluarën objekti kryesor i studimit nga gjuhëtarët e ndryshëm ishte aspekti historik i gjuhës shqipe, aspekti i lidhjeve të shqipes me gjuhët e tjera, d.m.th. historia e saj e jashtme, pas Çlirimit u vu në qendër të vëmendjes studimi i gjuhës së gjallë të popullit, i gjuhës letrare kombëtare shqipe, e parë kjo në sistem e në zhvi-

llim. Krahas kësaj studimi i historisë së gjuhës shqipe u vu në një bazë më të shëndoshë dhe u thellua në mënyrë të veçantë ndriçimi i historisë së brendshme të saj, duke shfrytëzuar gjerësisht edhe të dhënat e shumta të dialektologjisë së re shqiptare.

Në fund, prof. A. Kostallari, pasi foli për drejtimet dhe objektivat kryesore të punës së gjuhësisë sonë, për detyrat që i daliin asaj në të ardhshmen, sidomos për gjendjen e sotme e prirjet e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe si edhe për punën e madhe që na takon të bëjmë për njohjen sa më të thellë, për ruajtjen e për pasurimin e gjuhës sonë amtare, theksoi se një punë të veçantë duhet të bëjnë mësuesit e gjuhës e të letërsisë shqipe në të katër anët e Atdheut, si mbledhës e studjues të fjalës së bukur e të pastër shqipe nga goja e popullit, si luftëtarë për ngulitjen, përhapjen e zhvillimin e gjuhës letrare të përbashkët të kombit tonë.

Pastaj studentja Eliana Vrapi, në emër të studentëve premtoi se ata do të punojnë akoma edhe më shumë në të ardhshmen për të njohur dhe për të studjuar më thellë gjuhën e popullit dhe sukseset e gjuhësisë sonë.

Rrethi shkencor i gjuhësisë ka një plan të gjerë bisedash të tilla për të organizuar në të ardhshmen me pedagogë dhe studjues të gjuhësisë shqiptare të fushave të ndryshme, për t'u njohur më nga afër me sukseset e gjuhësisë sonë në vitet e Pushtetit Popullor dhe me punën e madhe e këmbëngulëse që bëjnë gjuhëtarët tanë për studimin e pasurive të gjuhës shqipe.

A Hidi